



QËNDRESA  
QYTETARE

# ANALIZA E KUSHTEVE HIGJIENO - SANITARE NË KONVIKTET E QYTETIT STUDENTI

- ANKETË -



TIRANË 02/2018

## ANALIZË E KUSHTEVE HIGJIENO - SANITARE NË KONVIKTET E QYTETIT STUDENTI

Rezidenca Studentore Universitare nr.1, e njohur ndryshe si Qyteti Studenti është konvikti më i madh në vend ku aktualisht akomodohen rreth 5300 studentë në 27 godina të ndara sipas gjinisë. Me iniciativën e një grupi studentësh që banojnë në Qytetin Studenti, dhe me indicien e një sërë artikujsh dhe emisionesh investigativë mbi kushtet e rënda të jetesës në këto godina, Qëndresa Qytetare zhvilloi një pyetësor drejtuar studentëve që banojnë aktualisht në këtë rezidencë për të marrë një informacion real dhe të vërtetë mbi kushtet e tualeteve, korridoreve dhe higjienës në ambientet ku ata kalojnë pjesën më të madhe të ditës.

Fokusi i pyetësorit u shtri gjithashtu edhe në një aspekt tjetër që përbën rrezik real për përhapjen e sëmundjeve në ambientet e jetesës së përbashkët. Sipas rregullores së Qytetit Studenti, në momentin e regjistrimit çdo student duhet të sjellë një paketë dokumentash ku të është i përfshirë edhe një dokument mjekësor i lëshuar nga mjeku i familjes ose urgjenca e Qytetit Studenti që vërteton se individit nuk mbart sëmundje ngjitëse të cilat mund të përbëjnë risk edhe për bashkëjetuesit në ambientet e konvikteve.

### METODOLOGJIA DHE DETAJET E KAMPIONIMIT

Për realizimin e kësaj analize është përdorur një metodologji që konsiston në mbledhjen e të dhënave primare.

Për të siguruar të dhënat primare janë hartuar pyetësorë standartë të cilët janë plotësuar nga studentët që banojnë në Qytetin Studenti. Pyetësorët tentojnë të përcaktojnë një lidhje midis asaj që studentët mendojnë për kushtet higjieno-sanitare në konvikt si edhe për vërtetimin mjekoligjor, dokument ky që shërben për t'u regjistruar në konvikt në fillim të vitit dhe impaktit që këto kushte kanë në ekuilibrin midis jetës së tyre shëndetësore dhe kushteve të jetesës.

Për këtë janë hartuar pyetësorë të plotësuar në mënyrë rastësore nga 300 studentë të moshës 18-27 vjeç, ku mosha mesatare e studentëve që banojnë në Qytetin Studenti është 20 vjeç.

Numri i viteve që theksohet më së shumti për qëndrimin e studentëve pranë konvikteve është deri në dy vjet por qëndrimi i tyre varion minimalisht duke nisur nga 1 vit dhe maksimalisht deri në 6 vjet.


Rezultatet e pyetësorit, përveç dëshmisë së këtij perceptimi do të ndihmojnë në dhënien e disa zgjidhjeve, mbështetur në rezultate, për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve higjieno-sanitare dhe reduktimin e marrjes së raportit mjeko-ligjor fiktivisht.

Teknika e përdorur është me anë të intervistës së drejtëpëdrejtë, ku pyetësorët janë plotësuar bazuar në deklaratimet individuale të studentëve, me një zgjedhje rastësore me hap të barabartë me 5 studentë dhe me nivel besueshmërie 95% dhe marzhi i gabimit 5%. Kryesisht përgjigjet e pyetësorit janë mbështetur duke përdorur pyetjet e mbyllura dhe të shkurtra, me qarkim, me përgjigje po/jo dhe shumë keq/shumë mirë.

Nga përzgjedhja rastësore e studentëve vërejmë që 71.4% (214 femra) që janë anketuar i përkasin gjinisë femërore dhe 28.6% (86 meshkuj) i përkasin gjinisë mashkullore.

Gjinia

M  
28.6%




F  
71.4%



## Analiza e të Dhënave Vërtetimi Mjekësor për Pranimë e Sëmundjeve Ngjitëse


Pyetjes nëse studentët e kanë marrë raportin mjeko – ligjor, që është kusht për t'u regjistruar në Qytetin Studenti, me apo pa vizitë mjekësore, rreth 70% e studentëve janë përgjigjur se nuk kanë kryer as vizitë as analiza, ndërsa 30% e tyre kanë pohuar se mjeku ka zhvilluar një vizitë përpara se të firmoste raportin e tyre mjekësor. Ky rezultat na lë të kuptojmë se 70% e studentëve janë potencialisht të rrezikshëm për cdo student nëse mbartin një sëmundje ngjitëse.

### Raportin Mjeko-Ligjor, e keni marrë:




Të gjithë studentët që janë të pajisur me kartë shëndeti dhe vërtetim nga universiteti duhet ta marrin falas raportin mjeko-ligjor. Nga pyetësi del se rreth 47% e tyre kanë paguar rryshfet për të marrë vërtetimin me ose pa vizitë mjekësore. Pra, kemi një situatë absurde ku mjekët jo vetëm që nuk të vizitojnë por marrin edhe rryshfet për të firmosur këtë dokument.

### Keni paguar rryshfet për të marrë raportin mjeko-ligjor?



Sa i përket institucionit se ku e kanë marrë vërtetimin mjekësor studentët, 60% e tyre janë përgjigjur se e kanë marrë pranë mjekut të familjes dhe rreth 37% pranë Urgjencës së Qytetit Studenti.


### Keni paguar rryshfet për të marrë raportin mjeko-ligjor?



# Higjena në Tualetet e Qytetit Studenti

## Si do i vlerësoni kushtet e higjenes se tualeteve te konvikteve?

Pyetjes mbi vlerësimin e kushteve të higjienës në tualetet e rezidencës universitare nr. 1, 34.5% e studentëve janë përgjigjur shumë keq, 30% keq, 33% mirë dhe vetëm 2.5% shumë mirë. Kjo pakënaqësi lidhet me përditshmërinë e tyre që fillon me oraret, temperaturën e ujit, mungesën e mjeteve kryesore dhe mungesën e një infrastrukture dinjitoze.




Duke e konsideruar si elementin kryesor të higjienës në tualete, studentët janë pyetur nëse ka ujë të rrjedhshëm në to. 68% e të pyeturve pohojnë se tualetet e godinës së tyre nuk kanë ujë të rrjedhshëm, ndërsa 32% pohojnë se në tualetet e godinës së tyre ka ujë të rrjedhshëm.

## A ka uje te rrjedhshem ne tualetet e konvikteve?


Jo 68%

Po 32%

Referuar pranisë së produkteve kryesore të higjienës që duhet të përmbajë tualeti, sic janë sapunët dhe letrat higjienike, produkte të cilat duhet të jenë prezente në cdo tualet normal, dhe që presupozohet se blihen me paratë që paguajnë studentët për tarifën e akomodimit, sipas 99% të studentëve të pyetur në tualetet e Qytetit Studenti nuk ka as sapunë as letra higjienike të vëna në dispozicion nga Drejtoria e rezidencës universitare nr. 1.



Një tualet sipas standarteve minimale normalisht duhet të ketë të paktën një derë funksionale. Sipas 86% të studentëve të pyetur tualetet e godinave të tyre nuk funksionojnë, ndërsa vetëm 14% e tyre pohojnë se dyert e tualeteve të godinave të konviktit janë funksionale.





**QËNDRESA  
QYTETARE**

**TIRANË 02/2018**